



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
Këshilli i Ministrave

**V E N D I M**

**Nr.1243, Datë 10.09.2008**

**MBI**

**“MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E KOHËS SË PUNËS TË PERSONAVE, QË KRYEJNË TRANSPORT RRUGOR, PËR ORËT E DREJTUESVE TË MJETEVE DHE PAJISJET E REGJISTRIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, neneve 176 dhe 177, të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe pikës 2, të nenit 76, të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 97, të ligjit Nr.7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Rregullores në organizimin e kohës së punës së personave, që kryejnë transport rrugor të lëvizshëm, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Neni 342 e 343, pikat 2 e 3, të vendimit nr.153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, “Rregullorja në Zbatim të Kodit Rrugor”, të ndryshuar shfuqizohen.
3. Pika 2, e VKM-së nr.360, datë 25.03.1996, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullimin e kohës së punës dhe të pushimit në ndërmarrjet e transportit automobilistik, hekurudhor, detar dhe ajror dhe ndërmarrjet që mirëmbajnë dhe riparojnë mjetet e transportit”, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë rregullore, shfuqizohen.
5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit,

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.

**K R Y E M I N I S T R I**

**SALI BERISHA**

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,  
TRANSPORTIT DHE  
TELEKOMUNIKACIONIT

**SOKOL OLLDASHI**

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE  
SOCIALE DHE SHANSEVE  
TË BARABARTA

**KOSTA BARKA**

**RREGULLAT NË ORGANIZIMIN E KOHËS SË PUNËS TË PERSONAVE, QË  
KRYEJNË TRANSPORT RRUGOR, PËR ORËT E DREJTUESVE TË MJETEVE  
DHE PAJISJET E REGJISTRIMIT**

## **KAPITULLI I**

### **Qëllimi e zbatimi**

#### **1. Të përgjithshme**

1.1. Kjo rregullore ka për qëllim vendosjen e kërkesave minimale në lidhje me organizimin e kohës së punës, përmirësimin në mbrojtjen e shëndetit dhe rritjen e sigurisë së personave që kryejnë veprimtari të transportit të rrugor të lëvizshëm, si dhe vendos rregulla në kushtet e konkurrencës.

1.2. Për arritjen e pikës 1.1, akti përcakton rregullat, për kohën e punës, për kohën e drejtimit të mjetit, periudhat e detyrueshme të ndërprerjeve dhe të pushimit për punëtorët e lëvizshëm, të përfshirë në transportin rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve.

#### **2. Zbatimi i rregullores**

2.1. Rregullorja zbatohet për mjetet e transportit rrugor:

- a) të mallrave, masa maksimale e lejuar e transportimit, duke përfshirë rimorkion ose gjysmë – rimorkion, është mbi 3.5 tonë; ose
- b) të përshtatshëm për udhëtarë me më shumë se nëntë persona duke përfshirë edhe drejtuesin e mjetit;
- c) të përshtatshëm për udhëtarë me nëntë persona përfshirë edhe drejtuesin e mjetit, të licencuar në shërbimin e rregullt, për linjat, sipas paragrafit të dytë, të nenit 17, të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar;
- ç) të përshtatshëm për udhëtarë me nëntë persona përfshirë edhe drejtuesin e mjetit, të licencuar në shërbimin taksit,

të cilët duhet të jenë të pajisura me pajisje regjistrimi (tahograf), me qëllim që të regjistrohet koha e drejtimit të mjetit, puna tjetër, periudhat e ndërprerjeve dhe pushimeve.

Mjetet sipas pikës 3, të kësaj rregulloreje, janë të përjashtuara e nuk do të kenë nevojë për t'u pajisur me tahograf.

2.2. Rregullorja zbatohet për ndërmarrjet e transportit të vendosura në Shqipëri, ndërsa ndërmarrjet e transportit të vendosura në një shtet tjetër dhe, kryejnë operacione transporti në, përmes, ose nga territori i Shqipërisë, do të zbatohen dispozitat e Tekstit të Konsoliduar të Marrëveshjes Europiane në Lidhje me Punën e Ekuipazheve të Mjeteve të Përfshira në Transportin Ndërkombëtar Rrugor (AETR).

2.3. Ndërmarrjet e transportit të vendosura në Shqipëri dhe kryejnë operacione transporti jashtë territorit të Shqipërisë, për këtë pjesë të udhëtimit do të veprojnë dispozitat e AETR-së. Dispozitat e AETR-së përfshihen në dispozitat e kësaj rregulloreje.

2.4. Rregullorja zbatohet për punëtorët e lëvizshëm të punësuar nga ndërmarrjet e vendosura Shqipëri, dhe ndaj të cilëve zbatohen pikat 2.4.1 dhe 2.4.2.

2.4.1 Kjo pikë zbatohet te punëtorët e lëvizshëm që merren ose për të punuar si drejtues, ose si udhëtues, në mjetet

- a). të cilët përputhen me kuptimin e “mjetit” në shkronjën “a”, të Aneksit 1;
- b). të cilët nuk përmenden në pikën 3 të kësaj rregulloreje;

2.4.2. Kjo pikë zbatohet për punëtorët e lëvizshëm ku pika 2.4.1 nuk zbatohet, dhe që merren ose për të punuar si drejtues, ose si udhëtues, në mjet

- a). të cilët përputhen me kuptimin e “mjetit” në nenin 1 të marrëveshjes AETR;
- b). të cilët nuk përmenden në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 2 të marrëveshjes AETR;
- c). të cilët janë duke kryer transport ndërkombëtar.

2.5. Rregullorja nuk zbatohet për punëtorin, puna e të cilit përfshihet në llogaritjen e kohës së punës:

- a). kur periudha referencë është më e shkurtër se 26 javë, për më pak se 11 ditë në periudhën referencë të zbatueshme te ky punëtor, ose
- b) në çdo rast tjetër për më pak se 16 ditë në periudhën referencë të zbatueshme për këtë punëtor.

2.6. Punëtori i lëvizshëm ka të drejtë, çdo vit, të marrë jo më pak se katër javë kalendarike pushime vjetore të paguara nga punëdhënësi. Ky kusht është i vendosur në marrëveshjen kolektive ose individuale.

### **3. Përfshirja nga zbatimi**

3.1. Drejtuesit e mjeteve janë të përfshiruar nga rregullat për orët e drejtuesve të mjeteve dhe nga rregullat e tahografit sipas pikave 6 – 10 dhe, ose AETR-së, kur përfshihen në operacionet e transportit në territorin e ndonjë Shteti Anëtar të KE-së dhe, ose në territorin e një vendi të tretë anëtar i Marrëveshjes AETR, kur:

- a) mjetet e përdorur në transportin rrugor të udhëtarëve të cilët me anë të konstruksionit dhe pajimit të tyre janë të përshtatshme për mbartjen e jo më shumë se nëntë personave, duke përfshirë drejtuesin e mjetit, dhe që janë të destinuar për këtë qëllim, e që nuk janë të përfshira në operacionet sipas shkronjave “c”, dhe “ç” të pikës 2.1;
- b) mjetet e përdorur në shërbimet e rregullta të transportit të udhëtarëve kur ky shërbim nuk i kalon 50 kilometrat distancë;
- c) mjetet me shpejtësi të autorizuar maksimale deri në 40 kilometra për orë;

- ç) mjetet e përdorur nga forcat të armatosura, mbrojtja civile, shërbimet zjarrfikëse, dhe forcat përgjegjëse të ruajtjes së rendit publik;
- d) mjetet e përdorur në lidhje me largimin e ujërave të zeza, mbrojtjen nga përmytjet, shërbimet e ujit të pijshëm, gazit dhe elektricitetit, mirëmbajtjen dhe kontrollin e rrugëve publike, mbledhjen e mbeturinave dhe shërbimet në rregullimin e telegrafit dhe telefonisë, transportin e artikujve postar, transmetimet e radios dhe televizionit dhe zbulimin e radios dhe televizionit transmetues ose marrës;
- dh) mjetet që zotërohen ose merren me qira pa drejtues mjete nga shërbimet e armatosura, shërbimet e mbrojtjes civile, zjarrfikëseve, dhe forca e ruajtjes së rendit publik, kur transporti ndërmerret për shkak të detyrave caktuara dhe është nën kontrollin e tyre;
- e) mjetet e përdorur për qëllime të ndihmës humanitare ose në operacione të emergjencës ose të shpëtimit;
- ë) mjetet që transportojnë pajisje të cirkut ose panairit;
- f) mjetet për qëllime mjekësore;
- g) mjetet e specializuara për avari;
- gj) mjetet që i nënshtrohen testeve rrugore për qëllime të zhvillimit të teknikës, riparimit ose mirëmbajtjes, dhe mjeteve të reja ose të rikonstruktuar, të cilët nuk janë futur ende në shërbim;
- h) mjetet e përdorur për transportime jo-tregtare të mallrave për përdorim personal;
- i) mjetet e përdorur për grumbullimin e qumështit nga fermat dhe kthimi në ferma të kontejnerëve të qumështi ose të produkteve të qumështit të destinuar për ushqimin e kafshëve.

Për kërkesat e orëve të drejtuesve dhe mbajtjen e regjistrimit për operacionet e mësipërme shiko kapitullin IV.

2. Drejtuesit e mjeteve janë gjithashtu të përjashtuar nga rregullat e orëve të drejtuesve të mjeteve dhe rregullat e tahografit sipas neneve 6 – 10 dhe, ose AETR-së kur përfshihen në operacionet e transportit brenda territorit të Shqipërisë, në lidhje me:

- a) mjetet e zotëruara ose të marra me qira, pa drejtues mjete, nga autoritetet publike të ndërmarrjes së transportit rrugor, e cila nuk konkurren ndërmarrjet private të transportit;
- b) mjetet e përdorur ose të marra me qira, pa drejtues mjete, nga ndërmarrjet bujqësore, kopshtarisë, pyjore, blegtorisë ose peshkimit për transportin e mallrave si pjesë e veprimtarisë së tyre në biznesin që zotëron brenda një rezeje 50 km nga vendndodhja e ndërmarrjes;

- c) traktorët bujqësor dhe traktorët pyjor që përdoren për veprimtaritë bujqësore ose pyjore, brenda një reze prej 50 km nga qendra e ndërmarrjes e cila i zotëron, i merr me qira ose me kontratë mjetet;
- d) mjetet ose kombinimi i mjeteve me një peshë të lejuar maksimale që nuk i kalon 7,5 tonët që mbartin materiale ose pajisje për përdorimin e drejtuesve në udhëtim për punën e tyre në një reze brenda 50 km nga vendi i ndodhjes së ndërmarrjes me kusht që drejtimi i mjetit nuk përbën veprimtarinë kryesore të drejtuesit;
- dh) mjetet e përdorur për mbartjen e mbeturinave ose skeleteve të kafshëve të cilët nuk janë të destinuar për konsum human;
- e) mjetet e përdorur për transportin e kafshëve të gjalla nga fermat te tregjet lokale dhe anasjelltas ose nga tregjet lokale te thertorja;
- ë) mjetet e përdorur si dyqan në tregjet lokale ose për shitje derë-më-derë ose e përdorur për veprime bankare të lëvizshme, transaksione të shkëmbimit ose të kursimit;
- f) mjetet që operojnë vetëm brenda në ishuj me një sipërfaqe që nuk i kapërcen 2,300 kilometra katror sipërfaqe, të cilët nuk lidhen me pjesën tjetër të Shqipërisë me një urë ose me tunel për përdorimin e mjeteve motorike;
- g) mjetet me një peshë (duke përfshirë edhe bateritë) jo më shumë se 7,5 tonë e përdorur për transportin e mallrave dhe vetëlëvizës me anën gazit natyral ose të lëngëzuar ose elektricitetit;
- gj) mjetet që përdoren për instruksion e drejtimit dhe provimin me synimin për të përfutur një leje drejtimi ose një certifikatë të kompetencës profesionale, me kusht që ato të mos jenë duke u përdorur për transport komercial të mallrave dhe udhëtarëve;
- h) mjetet e prodhuar para vitit 1 janarit 1947, të cilët nuk përdoren për qëllime komerciale;
- i) mjetet që lëvizin me anë të avullit;
- k) mjetet ndërmjet 10 deri 17 vende ulje të përdorur ekskluzivisht për transportin jo-tregtar të udhëtarëve;
- l) mjetet e lëvizshme speciale të përshtatur për shfaqje në ekran, qëllimi kryesor i të cilëve është përdorimi si një lehtësi edukimi kur qëndron;
- ll) mjetet e specializuara për transportin e monedhave dhe/ose sendeve me vlerë;
- m) mjetet që përdoren ekskluzivisht për lehtësirat në qendrat brenda rrugëve të tilla si portet dhe terminalët e hekurudhës;

Për kërkesat e orëve të drejtuesve dhe mbajtjen e regjistrimit për këto operacione shiko kapitullin IV.

## KAPITULLI II

### Koha e punës dhe e drejtimit, periudhat e ndërprerjes dhe të pushimit

#### 4. Koha e punës

4.1 Për punëtorin e lëvizshëm, koha e punës fillon dhe mbaron, kur ai ndodhet në vendin e punës, në dispozicion të punëdhënësit dhe, ose duke ushtruar funksionet e veprimtarisë së tij në lidhje me:

a) Kohën kushtuar të gjithë veprimtarisë së transportit rrugor, në mënyrë të veçantë:

- (i) drejtimit të mjetit;
- (ii) ngarkimit dhe shkarkimit;
- (iii) asistimit në imbarkimin e udhëtarëve dhe zbritjes së tyre nga mjete;
- (iv) pastrimit dhe mirëmbajtjes teknike;
- (v) të gjithë punët e tjera të caktuara për të garantuar sigurinë e mjetit, ngarkesës dhe udhëtarëve të tij, ose të plotësoj detyrimet direkt të lidhura me specifikën e operacionit të transportit që ka filluar, duke përfshirë monitorimin e ngarkimit dhe shkarkimit, formaliteteve administrative me policinë, doganat, zyrtarët e imigracionit, etj.,

b) Kohët gjatë të cilave ai nuk mund të vendosë lirisht për kohën e tij dhe të jetë në vendin e punës së tij, gati të nisë punën normale, me disa detyra të lidhura me detyrimet ekzistuese, në veçanti periudhat gjatë pritjes në ngarkimin ose shkarkimin, aty ku kohëzgjatja e parashikueshme e tyre nuk dihet më parë, domethënë ose para nisjes ose pikërisht para nisjes aktuale të periudhës në fjalë, ose sipas kushteve të përgjithshme të cilat vendosen në kontratën kolektive ose individuale.

4.2. Kohëzgjatja e punës javore, maksimale është 48 orë. Kjo kohë mund të shtrihet deri në 60 orë, përfshi orët jashtë orarit, në një javë të vetme, vetëm nëse gjatë katër muajve nuk kapërcehet mesatarja prej 48 orësh në një javë.

4.3. Pa cenuar pikën 4.2, periudha e referencë lejohet të zgjatet, për punëtorët e lëvizshëm ose grupe punëtorësh për objektiva ose arsye teknike ose arsye që lidhen me organizimin e punës, me anë të një marrëveshje kolektive ose individuale nga 17 deri në 26 javë.

Alternativat (zgjedhjet) e periudhave referencë për llogaritjen e kohës së punës javore mesatare dhe mënyrat e llogaritjes së saj caktohen me udhëzim të Ministrit. Në llogaritje, koha e punës javore për çdo periudhë referencë nuk duhet t'i kapërcej 48 orë.

4.4. Koha e punës për punëtorin e lëvizshëm për punëdhënësit të ndryshëm është shuma e kohëve të punës, që kryen te këta punëdhënësit. Punëdhënësi i kërkon me shkrim punëtorit të lëvizshëm të interesuar kohën e punës që shpenzon, nëse ai punon, për llogari të punëdhënësit tjetër. Punëtori i lëvizshëm i siguron atij një



informacion të tillë me shkrim.

4.5. Kohët e ndërprerjeve, pushimeve dhe periudhave të gatishmërisë nuk do të përfshihen në llogaritjet e kohës së punës.

4.6. Punëdhënësi duhet të mbaj regjistrime për çdo punonjës në veçanti, për t'i siguruar atyre mbrojtjen e nevojshme të shëndetit dhe për t'u siguruar që kufizimet e specifikuar më sipër janë plotësuara prej tij.

## **5. periudha e gatishmërisë**

5.1. Periudhat ndryshe nga periudhat e ndërprerjeve (pauzat) dhe periudhat e pushimit, gjatë të cilës punëtorit të lëvizshëm nuk i kërkohet të qëndrojë në vendin e tij të punës, në periudhën e gatishmërisë, atij i kërkohet të qëndrojë në vendin e tij të punës për qëllime të përgjigjes për telefonatat, në fillimin ose në përfundimin e drejtimit të mjetit ose të kryej punë tjetër.

Në mënyrë të veçantë periudha e gatishmërisë përfshin kohën e shpenzuar gjatë të cilës punëtori i lëvizshëm shoqëron një mjet, që është duke u transportuar me traget ose me tren, si edhe kohën e shpenzuar gjatë pritjes në kufijtë dhe ato gjatë ndalimeve të trafikut.

5.2. Periudhat e gatishmërisë dhe kohëzgjatja e parashikueshme e tyre duhet të njihen më parë nga punëtori i lëvizshëm para nisjes ose në momentin e nisjes aktuale, të cilat përcaktohen në kontratën kolektive ose individuale, në rast të kundërt ajo nuk do të trajtohet si periudhë gatishmërie.

5.3. Periudha e gatishmërisë nuk përfshin një periudhë pushimi ose ndërprerje.

5.4. Si periudhë e gatishmërisë për punëtorët e lëvizshëm që drejtojnë në ekip, do të pranohet edhe koha e shpenzuar duke qëndruar ulur pranë drejtuesit tjetër të mjetit ose në krevat, ndërsa mjete të lëvizshme, ose kur ndodhet në traget ose në tren.

## **6. Kohëzgjatja ditore, javore e dyjavore e drejtimit të mjetit**

6.1. Kohëzgjatja ditore e drejtimit të mjetit nuk duhet t'i kalojë 9 orë. Megjithatë, kohëzgjatja ditore e drejtimit të mjetit lejohet të shtrihet deri në 10 orë, por jo më shumë se dy herë (ditë) gjatë javës.

6.2. Kohëzgjatja javore e drejtimit të mjetit për drejtuesin nuk duhet t'i kapërcejë pesëdhjetëgjathtë (56) orë ndërmjet periudhave të pushimit javor, ose 58 orë nëse kohëzgjatja e drejtimit 6 ditor shtrihet në "dy javë".

6.3. Kohëzgjatja e përgjithshme e drejtimit të mjetit gjatë dy javëve të një pas njëshme nuk duhet t'i kapërcej nëntëdhjetë (90) orë.

6.4. Drejtuesi i mjetit regjistron si punë tjetër çdo kohë të shpenzuar siç përshkruhet në shkronjën "dh", të Aneksit 1, gjithashtu, çdo kohë të shpenzuar në drejtimin e mjetit të përdorur për operacione komerciale që nuk përputhen me qëllimin e kësaj rregulloreje, dhe do të regjistroj çdo periudhë të gatishmërisë, siç përcaktohet në pikën 5, që nga periudha e pushimit të fundit të tij ditore ose javore.

6.5. Kohëzgjatja e drejtimit ditore, javore ose dyjavore përfshin të gjithë kohën, si në Shqipëri dhe në territorin e Komunitetit European, dhe, ose atë të një vendi të tretë.

6.6. Punëdhënësi duhet të mbaj regjistrime për çdo punonjës në veçanti, për t'i siguruar atyre mbrojtjen e nevojshme të shëndetit dhe për t'u siguruar që kufizimet e specifikuar më sipër janë plotësuara prej tij.

## **7. Periudhat e ndërprerjes**

7.1. Kohëzgjatja e drejtimit të mjetit nuk duhet t'i kapërcej  $4\frac{1}{2}$  orë, pas kësaj periudhe drejtuesi i mjetit merr një periudhë ndërprerje të paktën 45 minuta për rifreskim, nëse nuk fillon periudhën e pushimit ditor ose javor.

7.2. Periudha e ndërprerjes prej 45 minuta të drejtimit të mjetit lejohet të zëvendësohet prej dy periudha ndërprerjesh, e para me anën e një periudhe ndërprerje prej 15 minuta e që vijon me një periudhë ndërprerje të dytë prej 30 minuta, gjatë periudhës së kohës së drejtimit të përmendur në pikën 7.1.

7.3. Gjatë periudhës së ndërprerjes, drejtuesi i mjetit nuk duhet të kryejë punë tjetër, sipas kuptimit të shkronjës "dh", të Aneksit 1. Në rastin kur mjete drejtohet nga dy drejtues, njëri prej atyre merr periudhën e ndërprerjes, ndërsa tjetri drejton mjetin.

7.4. Periudhat prej më pak se 15 minuta nuk llogariten si periudhë ndërprerje, ndonëse tahografi tregon pozicionin pushim.

7.5. Asnjë punëtor nuk punon më shumë se 6 orë pa një pushim. Kur koha e punës e punëtorit të lëvizshëm i kapërcen 6 orë por nuk i kalon 9 orë, ai duhet të ndërpresë punën për jo më pak se 30 minuta. Në rastin kur, koha e punës e punëtorit të lëvizshëm është më shumë se 9 orë, ai duhet të ndërpresë punën për jo më pak se 45 minuta.

7.6. Periudhat e ndërprerjeve sipas pikës 7.5 lejohet të ndahen prej jo më pak se 15 minuta secila.

7.7. Punëdhënësi duhet të mbaj regjistrime për çdo punonjës në veçanti, për t'i siguruar atyre mbrojtjen e nevojshme të shëndetit dhe për t'u siguruar që kufizimet e specifikuar më sipër janë plotësuara prej tij.

7.8. Ministri me udhëzim harton shembuj të modeleve të zbatueshme të periudhave të ndërprerjeve gjatë kohës ditore të drejtimit të mjetit, sipas pikës 6.

## **8. Periudha e pushimit ditor**

8.1. Pas përfundimit të periudhës së pushimit ditor ose të periudhës së pushimit javor të mëparshme, në çdo periudhë prej 24 orë, drejtuesi i mjetit duhet të marrë një periudhë të re të pushimit ditor, e cila duhet të jetë jo më pak se 11 orë të vazhdueshme. Kjo periudhë pushimi ditore e rregullt lejohet të reduktohet te një minimum prej 9 orë, por jo më shumë se 3 herë në javë, për aq sa ky reduktim kompensohet nga një pushim ekuivalent para mbylljes së javës në vijim.

8.2. Një periudhë e pushimit ditor lejohet të shtrihet për t'u kryer brenda një periudhe pushimi të rregullt javore ose një periudhe të pushimi të reduktuar javore.

8.3. Në mënyrë alternative, kur pushimi ditor prej 12 orë nuk reduktohet sipas pikës 8.1, lejohet të ndahet gjatë periudhës prej 24 orë në dy periudha të veçanta, nga të cilat, kohëzgjatja e periudhës së fundit duhet të jetë të jetë jo më pak se 9 orë të vazhdueshme, dhe tjetra jo më pak se një 3 orë.

8.5. Përfundimisht nga pika 8.1 dhe 8.3, brenda 30 orëve nga përfundimi i periudhës së pushimit ditor ose javor, drejtuesi i mjetit, që është i përfshirë në ekip, duhet të marrë një periudhë të re pushimi ditore të paktën 9 orë.

Për orën e parë të drejtimit në ekip, prezenca e drejtuesit/drejtuesve është opsionale, por për periudhën e mbetur ajo është e detyrueshme.

8.6. Kur në mjet ndodhen më shumë se një drejtues, drejtuesit e tjerë lejohet të marrin një periudhë ndërprerje (pauzë), ndërsa tjetri është duke drejtuar mjetin, por jo të marrin një periudhë të pushimit ditor.

8.7. Kur drejtuesi i mjetit merr periudhat e pushimit ditor larg vendqëndrimit të ndërmarrjes, ato lejohen të merren në mjet nga drejtuesit i tij, vetëm kur mjeti është i pajisur me krevat marinari për secilin drejtues, dhe kur mjeti është në gjendje qetësie (të palëvizshme).

8.8. Në periudhën e orëve të punës përfshihen edhe periudhat e ndërprerjes (pauzë).

8.9. Punëdhënësi duhet të mbaj regjistrime për çdo punonjës në veçanti, për t'i siguruar atyre mbrojtjen e nevojshme të shëndetit dhe për t'u siguruar që kufizimet e specifikuar më sipër janë plotësuara prej tij.

## **9. Periudha e pushimit javor**

9.1. Një periudhë pushimi ditore shtrihet brenda një periudhë pushimi javore, prej të paktën 45 orë të vazhdueshme. Periudha e pushimit javor lejohet të reduktohet më pak se 45 orë, por jo të jetë më e vogël se 24 orë të vazhdueshme. Periudha e pushimit javor lejohet të zhvendoset deri në përfundimin e ditës së gjashtë nëse koha e drejtimit të mjetit gjatë gjashtë ditëve nuk e kapërcen maksimumin që i korrespondon periudhave të drejtimit prej gjashtë ditëve.

9.2. Në çdo dy javë të vazhdueshme, drejtuesi i mjetit merr së paku dy periudha pushimi javore të rregullt, ose një periudhë pushimi javor të rregullt dhe një periudhë pushimi javor të reduktuar prej jo më pak se 24 orë. Megjithatë reduktimi do të kompensohet nga një periudhë ekuivalente pushimi i marrë në bllok para përfundimit të javës së tretë që pason javën në fjalë. Pushimi i marrë si kompensim për periudhën e pushimit javor të reduktuar duhet të bashkëlidhet te një tjetër periudhë pushimi prej të paktën 9 orë.

9.3. Një periudhë pushimi javor fillon jo më vonë se fundi i gjashtë periudhave prej 24 orë nga përfundimi i periudhës së pushimit javor të mëparshëm.

9.4. Kur drejtuesit e mjeteve marrin periudhat e pushimit javor larg vendqëndrimit,

ata lejohen të marrin në mjet periudhat e pushimit javor vetëm kur kanë kushte të përshtatshme për fjetje për secilin drejtues dhe, kur mjeti është në gjendje qetësie (të palëvizshme).

9.5. Periudha e pushimit javor që bie ndërmjet dy javëve llogaritet brenda një jave, por jo në të dyja.

9.6. Koha e pushimit për kursantët do të llogaritet në përputhje me dispozitat e pikave 8 - 9.

9.7. Punëdhënësi duhet të mbaj regjistrime për çdo punonjës në veçanti, për t'i siguruar atyre mbrojtjen e nevojshme të shëndetit dhe për t'u siguruar që kufizimet e specifikuara më sipër janë plotësuara prej tij.

## **10. Transporti me traget ose tren**

10.1 Përrjashtimisht nga pikat 8 dhe 9, kur një drejtues mjeti shoqëron një mjet i cili transportohet me traget ose me tren, dhe merr një periudhë pushimi të rregullt ditore jo më pak se 11 orë, kjo periudhë mund të ndërpritet jo më shumë se dy herë nga veprimtari të tjera që nuk e kapërcejnë një orë në total. Gjatë kësaj periudhe pushimi të rregullt ditore, drejtuesi i mjetit përdor krevat.

10.2. Çdo kohë e shpenzuar duke udhëtuar në një vend për të marrë në ngarkim një mjet që përputhet me dispozitat e këtij ligji ose në kthim nga ai vend, kur mjeti nuk është në shtëpinë e drejtuesit të mjetit as në qendrën operacionale të punëdhënësit ku normalisht ai është i vendosur, nuk konsiderohet si pushim ose periudhë ndërprerje, vetëm nëse drejtuesi i mjetit është në anije ose në tren dhe përdor një krevat.

10.3. Çdo kohë e shpenzuar nga drejtuesi i mjetit, që drejton një mjet që nuk përputhet me dispozitat e kësaj rregulloreje për në ose nga mjeti, që përputhet me dispozitat e kësaj rregulloreje, i cili nuk gjendet në shtëpinë e drejtuesit të mjetit ose në qendrën operacionale të punëdhënësit, ku drejtuesi i mjetit është i vendosur normalisht, konsiderohet si punë tjetër.

10.4. Punëdhënësi duhet të mbaj regjistrime për çdo punonjës në veçanti, për t'i siguruar atyre mbrojtjen e nevojshme të shëndetit dhe për t'u siguruar që kufizimet e kushtet e specifikuara më sipër janë plotësuara prej tij.

## **11. Puna e natës**

11.1. Puna e natës kufizohet deri në 10 orë kohë pune në një periudhë 24 orë, ku çdo punë kryhet gjatë periudhës kohë – nate, e cila për mjetet e mallrave merret nga ora 00.00 - 04.00, ndërsa për udhëtarët merret periudha ndërmjet orës 01.00 - 05.00.

11.2. Periudha prej 10 orë mund të zgjatet më shumë për punëtorët e lëvizshëm të veçantë ose grupe punëtorësh për arsye teknike ose arsye që lidhen me organizimin e punës. Zgjatja e kësaj periudhe lejohet vetëm me marrëveshje kolektive ose individuale.

11.3. Kompensimi për punën e natës nuk duhet t'i jepet punëtorit të lëvizshëm nga punëdhënësi në një mënyrë të tillë, që e bën përgjegjës atë, për të rrezikuar sigurinë

në rrugë.

11.4. Punëdhënësi duhet të mbaj regjistrime për çdo punonjës në veçanti, për t'i siguruar atyre mbrojtjen e nevojshme të shëndetit dhe për t'u siguruar që kufizimet e specifikuara në pikën 11.1 dhe 11.2 më sipër janë plotësuar prej tij.

## **12. njoftimi e regjistrimi**

12.1 Punëdhënësi njofton çdo punëtor të lëvizshëm për rregullat e këtij akti, me rregullat e brendshme të ndërmarrjes, si dhe dispozitat e marrëveshjeve dypalëshe në fuqi, që janë të zbatueshme për punëtorët. Ministri, me udhëzim, përcakton detyrimet që duhet të plotësoj punëtori i lëvizshëm, si dhe detyrimet e punëdhënësit për mbajtjen regjistrimeve.

12.2 Regjistrimet e personave që kryejnë veprimtari të transportit rrugor të lëvizshëm mbahen për dy vjet pas fundit të periudhës së mbuluar. Punëdhënësi mban përgjegjësi për kopjet e regjistrimeve të orëve të punës, të punëtorëve të lëvizshëm

## **KAPITULLI III**

### **Përgjegjësia e ndërmarrjeve të transportit, përjashtimet dhe emergjencat**

## **13. Përgjegjësia**

13.1. Ndërmarrja e transportit ndalohet të japë shpërblime ose pagesa për drejtuesit e mjeteve të saj në formën e një bonusi ose pagesa shtesë nëse ato lidhen me distancën e udhëtuar prej tyre dhe, ose sasinë e mallrave të transportuar, të cilat bëhen shkak për shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje duke rrezikuar sigurinë rrugore.

13.2. Ndërmarrja e transporti rrugor organizon punën e drejtuesve të mjeteve në mënyrë të tillë që drejtuesit e mjeteve të jenë të aftë të zbatojnë rregullat e përdorimit të tahografit sipas rregullores së përdorimit dhe kapitullit II, të kësaj rregulloreje.

Ndërmarrja e Transportit instrukton drejtuesit e mjeteve dhe kryen kontrole të rregullta për zbatimin e rregullores për pajisjen e regjistrimit në transportin rrugor.

13.3. Ndërmarrja e transportit rrugor është përgjegjëse për shkeljet e ndodhura nga drejtuesit e mjeteve të saj edhe nëse shkeljet janë kryer në territorin e një shteti Anëtar të KE-së ose vendi të tretë.

13.4. Të gjithë pjesëmarrësit e një zinxhiri në transport, si ndërmarrjet, dërguesit, agjentët spedicionerë të transportit të mallrave, operatorët e transportit të mallrave dhe ata turistik dhe nënkontraktorët e transportit për zhvillimin normal të veprimtarisë së tyre ndërtojnë programet e transportit në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe, ose të AETR-së.

13.5 Ndërmarrja e transportit, e cila përdor mjete të përshtatur me pajisje regjistrimi, (tahografin) dixhitale, sipas rregullores së përdorimit, duhet të garantoj:

- i). që të gjitha të dhënat janë transferuar nga njësia e mjetit (NjM) dhe nga karta e drejtuesit me frekuencë të tillë që të sigurojnë, që të dhënat lidhur me veprimtaritë e ndërmarrja në lidhje me, ose për këtë ndërmarrje janë transferuar;
- ii). që të gjitha të dhënat e transferuara nga të dyja, nga njësia e mjetit (NjM) dhe karta ruhen se paku 24 muaj nga regjistrimi dhe nëse një zyrtar i kontrollit i kërkon, ato duhet të jenë disponibël, direkt ose në distancë, nga ambientet ( zyrtar ) e ndërmarrjes;

13.6. Për qëllime të kësaj pike “transferim” do të interpretohet në përputhje me përkufizimin e formuluar në Aneksin 1, të kësaj rregulloreje.

13.7. Periudha maksimale brenda të cilës të dhënat përkatëse duhet të transferohen sipas pikës 13.5. (i), caktohet me udhëzim të Ministrit, i cili merr edhe mendimin e shoqatave të transportit.

## **14. Përjashtimet**

14.1. Drejtuesit e veprimtarisë së ndërmarrjes së transportit programojnë punën e drejtuesve të mjeteve, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje. Megjithatë, kur drejtuesi i mjetit nuk rrezikon sigurinë në rrugë lejohet të shmang pikat 6 deri në 10, nëse ky veprim shërben për të garantuar sigurinë e jetës së personave të mjetit, ose të ngarkesës së tij.

14.2. Në zbatim të pikës 14.1, drejtuesi i mjetit, me mbërritjen në vendqëndrimin e përshtatshëm të mjetit, duhet të shënojë arsyet e shmangies mbi fletën e regjistrimit të tahogرافit analog, ose mbi fletën e printuar nga pajisja regjistruese, kur përdoret tahogرافi dixhital, ose në regjistrin e shërbimit.

14.3. Shmangia nga rregullat që përfshijnë pikat 6 deri në 10 zbatohet vetëm në raste të paparashikueshme dhe emergjente në plotësimin e rregullave të drejtuesit të mjetit gjatë udhëtimit. Rastet e përsëritura të pikës 14.1, tregojnë se drejtuesit e veprimtarisë së ndërmarrjes nuk programojnë punën e drejtuesve të mjeteve në përputhje me pikat e përmendura.

14.4 Përjashtim nga rregullat e pikave 6 deri në 10 lejohet vetëm në rastin e transportit me mjete jashtë norme dhe kur ato janë të shoqëruara nga policia rrugore ose nga vetë ndërmarrja e transportit, me autorizim të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

## **15. Emergjencat**

15.1. Për arsye të rrethanave të jashtëzakonshme, rregullat e veçanta pezullohen për operacione, të cilat lidhen me ngjarje që kërkojnë veprime të menjëhershme për shmangien nga rreziku i jetës ose i shëndetit të njerëzve ose kafshëve; ndërprerjen e shërbimeve thelbësore për publikun (gazi, uji i pijshëm, elektriciteti ose kullimi i ujërave të zeza), ose shërbimeve të telekomunikacionit ose atyre postare, ose përdorimin e rrugëve, hekurudhave, porteve, aeroporteve; dëmtime të pronës.

15.2. Për këto raste, kufizimet për kohën e drejtimit të mjetit ose të punës dhe kohëzgjatjen e pushimeve të përcaktuara në pikat 6 deri në 9 pezullohen deri me

përfundimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme sipas pikës 15.1.

15.3. Për arsye të rrethanave të jashtëzakonshme, Ministri për të gjithë territorin e vendit ose Prefekti për qarkun, me urdhër lejojnë përjashtime nga zbatimi i pikave 6 deri në 9, për operacionet e transportit të kryera nga transportuesit shqiptar ose nga transportuesit e huaj në, përmes, ose nga territori i Shqipërisë. Në këto raste kohëzgjatja e përjashtimit është në përputhje me pikën 15.2, por jo më madhe se 30 ditë.

#### **KAPITULLI IV**

### **Shërbimet e rregullta në transportin e udhëtarëve, rregullat e veçanta e përjashtimet nga këto rregulla**

#### **16. Operacionet e transportit kur mjete i udhëtarëve nuk është i pajisur me pajisje regjistruese (tahografi)**

16.1. Në rastin kur pajisja e regjistrimit (tahografi) nuk është përshtatur në mjet sipas rregullores së tahografit, pika 16.2 do të zbatohet për:

- a) Shërbimet e rregullta, të brendshme të udhëtarëve, dhe
- b) Shërbimet e rregullta ndërkombëtare të udhëtarëve, терминаlet e udhëtimit të cilëve ndodhen brenda një distance prej 50 km në vijë të drejtë nga një kufi ndërmjet dy Shteteve Anëtare dhe gjatësia e udhëtimit nuk i kalon 100 km.

16.2. Lista e orareve dhe regjistri i shërbimit me detyrat përkatëse hartohen nga drejtuesit e veprimtarisë së ndërmarrjes së transportit për anëtarët e ekuipazhit; regjistri i shërbimit duhet të tregoj emrin e drejtuesit të mjetit, vendin ku ai e ka bazën (qendrën), dhe programin e bërë më parë për periudhat e ndryshme të drejtimit, punës tjetër dhe periudhën e gatishmërisë; regjistri i shërbimit duhet të përfshij këto detaje për javën e mëparshme, asaj në vijim dhe asaj që pason; regjistri i shërbimit duhet të nënshkruhet nga drejtuesi i veprimtarisë së ndërmarrjes ose personi i autorizuar; regjistri i shërbimit duhet të mbahet në zyrat e ndërmarrjes për inspektim për një periudhë një vjeçare.

16.3. Pa cenuar shkronjën "a", të pikës 3.1, drejtuesit e mjeteve të mallrave me masë maksimale të lejuar të transportimit nga 1.5 deri në 3.5 tonë regjistrojnë udhëtimet e tyre në regjistrin e udhëtimit.

16.4. Modelet e regjistrimit të shërbimit që përmbajnë fletët e regjistrimit javor, listës së orareve dhe caktimi i agjencive të shpërndarjes së tyre përcaktohen me udhëzim të Ministrit.

16.5. Drejtuesi i mjetit i caktuar për një shërbim të përmendur në pikën 16.1 do të mbart me vete një ekstrakt nga regjistri i shërbimit me detyrat përkatëse dhe një kopje të listës së orareve të shërbimit. Këto dokumente i paraqiten dhe i dorëzohen zyrtarit inspektues të autorizuar me kërkesën e tij.

#### **17. Rregullat e veçanta në transportin e brendshëm udhëtarëve.**

17.1. Rregullat e veçanta zbatohen te disa udhëtime brenda territorit të Shqipërisë në transportin e udhëtarëve, të cilat nuk i nënshtrohen rregullave të pikave 6 – 9, për:

a). drejtuesit e autobusëve në shërbimin e rregullt deri në 50 km në transportin brenda vendit të udhëtarëve.

b). drejtuesit e mjeteve për operacionet e transportit brenda vendit në shërbimet e rregullta që i kapërcejnë 50 km, me autovetura me 9 vende në përputhje me paragrafin e dytë, të nenit 17, të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar dhe me autobus 9 deri në 17, vende ulje.

Përjashtimisht shkronjës “b”, autobusët me ose mbi 18 vende ulje zbatohen rregullat e pikave 6 – 9. Shiko Aneksin 2.

c). drejtuesit e mjeteve për operacionet e transportit në shërbimet e rastit brenda vendit për autobusët me 10 deri në 17, vende ulje

Për autobusët me ose mbi 18 vende ulje zbatohen rregullat e pikave 6 – 9. Shiko Aneksin 2.

Në Aneksin 2 jepen rregullat që duhet të zbatohen për lloje të ndryshme mjetesh në transportin e udhëtarëve brenda vendit dhe ndërkombëtar.

17.2. Në rastin e transportit të brendshëm ose ndërkombëtar të udhëtarëve, me përjashtim të shërbimeve të rregullta, drejtuesit të mjetit i lejohet të zhvendos pushimin javor deri në fund të ditës së dymbëdhjetë, kur duhet të merret periodha e pushimit javor.

17.3. Në rastin e transportit të udhëtarëve në shërbimet e rregullta që nuk i kapërcen 50 km, periodha e ndërprerjes minimale prej jo më pak se 30 minuta mund të merret pas një periudhe drejtimi që nuk i kapërcen 4 orë. Përjashtime të tilla jepen vetëm në rastet kur periodha e ndërprerjes në drejtimin prej mbi 30 minuta mund të vështirësoj rrjedhjen e trafikut urban dhe kur nuk është e mundur për drejtuesit e mjeteve të marrin 15 minuta ndërprerje brenda  $4\frac{1}{2}$  orë të drejtimit marrin më parë një ndërprerje 30 minuta.

17.4. Kufizimet në drejtimin e mjetit jepen për:

a). drejtuesin e mjetit, i cili nuk mund të drejtoj më shumë se 10 orë në një ditë duke përfshirë edhe ndonjë drejtim të mjetit të kryer sipas rregullave të AETR-së.

b). drejtuesin e mjetit që kryen veprimtari transporti rrugor, pas një kohëzgjatje drejtimi të vazhdueshëm të mjetit ose të mbledhur prej  $5\frac{1}{2}$  orë merr një periudhë ndërprerje, të paktën prej 30 minuta, për rifreskim;

ose në çfarëdo periudhe brenda  $8\frac{1}{2}$  orë ditë pune, shuma e periudhave të ndërprerjeve është të pakën 45 minuta, kështu që drejtuesi i mjetit nuk drejton mjetin më shumë se  $7\frac{3}{4}$  orë. Drejtuesi i mjetit, veç kësaj, duhet të ketë të pakën 30 minuta për të përfutuar pushim ose rifreskim në fund të kësaj periudhe, veç po të mos jetë fundi i ditës së punës.



Periudhat e ndërprerjeve mund të ndahen secila nga 15 minuta brenda periudhave të kohës së punës.

17.5. periudha e pushimit ditor është 10 orë të vazhdueshme dhe duhet të merret ndërmjet dy ditëve të punës. Kjo mund të reduktohet deri në 8<sup>1</sup>/<sub>2</sub> orë deri tre herë në javë.

17.6. periudha e pushimit dyjavore, në çdo dy javë të njëpasnjëshme, (e hënë deri të diel) duhet të jetë të paktën një periudhë prej 24 orë.

## **18. Rregullat e veçanta në transportin e brendshëm të mallrave**

18.1. Rregullat e veçanta zbatohen te shumica e mjeteve të transportit të mallrave që janë të përjashtuar nga dispozitat e pikës 3, si dhe për mjetet e transportit të mallrave me kapacitet nën 3,5 tonë deri në, dhe 1,5 tonë.

18.2. Kufizimet në drejtimin e mjetit zbatohen kur:

a). drejtuesi i mjetit nuk mund të drejtoj më shumë se 10 orë në një ditë duke përfshirë edhe ndonjë drejtim të mjetit të kryer sipas rregullave të AETR-së.

Kufizimi i drejtimit ditor zbatohet, kur drejtuesi i mjetit aktualisht drejton një mjet. Drejtimi jashtë rrugëve publike për qëllime të agrikulturës, xeherorëve, pyjeve, punës ndërtimore ose inxhinierisë civile llogaritet si detyrë në vend të kohës së drejtimit.

b) drejtuesi i mjetit nuk duhet të jetë në detyrë më shumë se 11 orë në një ditë pune. Drejtuesi i mjetit përjashtohet nga kufizimi ditor në punë, në një ditë pune, kur ai nuk drejton.

c). drejtuesi i mjetit, i cili nuk drejton për më shumë se 4 orë në çdo ditë pune të javës, përjashtohet nga kufizimi ditor në punë.

## **19. Përjashtimi nga rregullat e veçanta**

19.1. Përjashtimi nga rregullat e veçanta do të zbatohet për:

a) drejtuesit e mjeteve e përdorur nga Forcat e armatosura, Policisë dhe Reparteve të zjarrfikësve;

b) drejtuesit e mjeteve të cilët gjithmonë drejtojnë jashtë sistemit rrugor publik;

c) drejtimin privat, d.m.th. që nuk lidhet me një punë që shërben si mjet jetese;

19.2. Drejtuesit e mjeteve, të cilët janë të përjashtuar nga kufizimi i kohës së punës, por jo në kufizim të drejtimit të:

a) mjeteve të mallrave, që përfshijnë mjetet e qëllimit të dyfishtë, që nuk kapërcejnë masën e lejuar maksimale prej 3.5 tonë, të cilët përdoren:

- i) nga mjekët, stomatologët, infermieret, mamit dhe veterinerët;
- ii) për çdo shërbim inspektimi, pastrimi, mirëmbajtje, riparimi, instalimi ose montimi;
- iii) nga një përfaqësues tregtar; ose
- iv) për kinematografi ose transmetimet e radios dhe televizionit.

19.3. Në transportin rrugor të udhëtarëve, rregullat e veçanta zbatohen për:

- a) drejtuesit e mjeteve, që nuk drejtojnë më shumë se 4 orë në ditë në një javë janë të përjashtuar nga çdo rregull i brendshëm, për atë javë.
- b) drejtuesit e mjeteve që drejtojnë më shumë se 4 orë për deri në 2 ditë në një javë, janë të përjashtuar nga rregullat, por me kusht që:
  - i) të gjithë detyrimet e punës duhet të fillojnë e përfundojnë brenda 24 orëve;
  - ii) të kenë 10 orë të pandërprera pushimi, menjëherë para detyrës së re (parë) dhe menjëherë pas detyrës së fundit;
  - iii) të zbatojnë rregullat mbi kohën e drejtimit dhe gjatësinë e ditës së punës.

19.4. Nëse ndonjë ditë pune përkon brenda javës në të cilën drejtuesi i mjetit nuk është i përjashtuar nga rregullat, atëherë këtë ditë drejtuesi i mjetit duhet të zbatoj kufizimet për kohën e drejtimit të mjetit dhe kohëzgjatjen e ditës së punës.

19.5. Ditën që drejtuesi i mjetit ushtron veprimtari në një emergjencë, ai është i përjashtuar, gjatë kësaj dite, nga rregullat për kohëzgjatjen e drejtimit të mjetit dhe periudhën e pushimit.

## **20. Përjashtimi nga mbajtja e regjistrimeve**

Veprimtaritë si vijon, përjashtohen nga mbajtja e regjistrimeve për:

- a) drejtuesit e mjeteve të mallrave, të cilët nuk kërkojnë licencë për veprimtarinë në transportin rrugor të mallrave, sipas nenit 44, të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" të ndryshuar, dhe udhëtarëve.

Përjashtimi nuk zbatohet te drejtuesit e mjeteve të Presidencës, të cilët do të kishin nevojë për një operator transporti të licencuar, nëse mjete nuk është pronë e Presidencës;

- b) drejtuesit e mjeteve të mallrave në cilëndo ditë kur ata drejtojnë për 4 orë ose më pak, dhe me reze brenda 25 kilometrave nga vendndodhja e tij;
- c) drejtuesit që përdorin një tahograf të kalibruar dhe plumbosur në përputhje me Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

## **21. Drejtimi i më shumë se një mjete**

Nëse një drejtues drejton dy mjete, njërin për transportin e udhëtarëve dhe tjetrin për transportin e mallrave, ai duhet të mbajë e të veprojë në përputhje me rregullat e këtij akti për të dy llojet e mjeteve.

## **22. Shërbimet postare me mjete mbi 3.5 tonë**

Tahografët duhet të vendosen dhe përdoren në të gjithë mjetet me një peshë maksimale që i kapërcen 3.5 tonët, të cilët kryejnë shërbime postare të pakove ose letrave. Drejtuesit e mjeteve të tilla përjashtohen nga rregullat e pikave 6 – 9 për orët e drejtuesit, por duhet të jenë në përputhje me rregullat e veçanta sipas pikave 18 – 19.

### **KAPITULLI V**

#### **Drejtimi i mjetit pjesërisht sipas dispozitave të AETR-së dhe rregullave të veçanta**

## **23. Drejtimi i përzier i mjetit**

23.1. Nëse drejtuesi i mjetit kryen udhëtime pjesërisht sipas dispozitave të AETR-së dhe pjesërisht sipas rregullave të veçanta, ndoshta edhe në të njëjtën ditë, duhet të merren parasysh çështjet që vijojnë:

- a) koha e shpenzuar në drejtimin e mjetit sipas rregullave të AETR-së nuk llogaritet si periudhë e mbyllur (jo – punuese) sipas rregullave të veçanta;
- b) puna e drejtimit dhe puna tjetër sipas rregullave të veçanta (duke mos përfshirë punën e drejtimit në një punëdhënës tjetër) llogaritet si pjesëmarrje në punë, por jo si një periudhë ndërprerje ose pushimi sipas rregullave të AETR-së;
- c) drejtimi i mjetit sipas rregullave të AETR-së llogaritet drejt kufizimeve në drejtimin e mjetit dhe detyrave sipas rregullave të veçanta; dhe
- ç) cilido drejtim sipas AETR-së në një javë nënkupton që drejtuesi i mjetit duhet të marrë një periudhë pushimi ditore në ato ditë kur ai/ajo drejton aktualisht sipas rregullave të AETR-së, dhe një periudhë pushimi javore.

23.2. Koha e punës është deri në 11 orë, por kur udhëtohet jashtë territorit, periudha e gatishmërisë, kohëzgjatja e drejtimit të mjetit, periudhat e ndërprerjes, periudhat e pushimit ditor, javor, dyjavor, zbatohen rregullat e AETR-së, vetëm për ato ditë ku aktualisht drejtohet.

23.3. Nëse drejtuesi i mjetit drejton pjesërisht sipas rregullave të veçanta dhe pjesërisht sipas rregullave të AETR-së, ai duhet të shënojë në fletën e regjistrimit të tahografit (kur ai është analog) për të treguar periudhën e drejtimit brenda vendit si punë tjetër, ose duke u futur lehtësisht në mënyrë manuale, (ku ai është tahograf dixhital) që tregon periudhën e drejtimit brenda si punë tjetër.

### **KAPITULLI VI**

#### **Pajisjet e regjistrimit (tahografët) analoge dhe dixhitale, miratimi i tipit,**

## **verifikimi, instalimi e inspektimit i tyre**

### **24. pajisjet e regjistrimit**

24.1. Paisjet regjistruese në transportin rrugor (tahografet analog dhe dixhitale) janë të nevojshme për t'u vendosur në mjetet sipas pikës 2. Ato do të konsiderohen si instrumenta matës ligjërish të kontrolluara e do t'i nënshtrohen kontrollit ligjor sipas procedurave të metrologjisë ligjore në mbështetje të ligjit Nr. 9875 datë 14.02.08 "Për metrologjinë" dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

24.12. Tahografi analog ose dixhital ëshë një paisje matëse që tregon dhe regjistron shpejtësinë e çastit dhe distancën e përgjithshme të kryer nga automjeti. Ai gjithashtu regjistron kohën e drejtimit të mjetit, punën tjetër, periudhat e ndërprerjes dhe periudhat e pushimit. Tahografët janë dy lloje:

- a) tahografi analog i cili kryen regjistrime mbi një fletë letre të rumbullakët, dhe
- b) tahografi dixhital, i cili kërkon përdorimin e kartës së drejtuesit të mjetit për të mundësuar drejtuesin e mjetit në regjistrimin e veprimtarisë së drejtimit. Karta e drejtuesit do të regjistrojë dhe magazinojë të dhënat në lidhje me veprimtarinë e drejtuesit dhe mjetet që ai ka drejtuar, ndërsa njësia e mjetit (NjM) të tahografit dixhital do të regjistroj veprimtarinë e mjetit dhe të drejtuesve që e kanë drejtuar atë mjet. Nga njësia e mjetit (NjM), informacioni shfaqet visualisht, transferohet elektronikisht, ose printohet.

### **25. Miratimi i tipit**

Miratimi i tipit (si dhe njohja e miratimit ë tipit) të tahografit dhe e fletës së letrës së regjistrimit që përdoret në këtë tip bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë sipas procedurave përkatëse në mbështetje të ligjit "Për metrologjinë" dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

### **26. Verifikimi**

26.1. Verifikimi fillestar dhe periodik i tahografëve bëhet nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjisë apo person juridik ose fizik i autorizuar në mbështetje të ligjit "Për metrologjinë" dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

26.2. Verifikimi fillestar dhe periodik i tahografëve (përfshi përcaktimin e afateve të riverifikimit) kryet në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të ligjit "Për metrologjinë".

### **27. Instalimi dhe riparimi**

Instalimi dhe riparimi i tahografëve bëhet nga persona juridike ose fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë sipas kritereve të përcaktuara dhe miratuara me udhëzim të Ministrit që mbulon fushën e Metrologjisë.

### **28. Tarifat e shërbimeve**

Miratimi i tipit, njohja e miratimit të tipit, verifikimi fillestar, verifikimi perdioidik, instalimi dhe riparimi i tahografëve, kalibrimi bëhet sipas tarifave të miratura nga Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

## Kapitulli VII

### 29. Marrja e masave

29.1. Masat që merren nga drejtuesi i mjetit, në rastet kur pajisja e tahografit analog difektohet me vulë të prishur ose ka ndonjë dyshim rreth mirëfunksionimit të tij, riparimit ose zëvendësimit i tij gjatë udhëtimit, si dhe përgjegjësia e drejtuesit të mjetit ose e ndërmarrjes për këto probleme, caktohen me udhëzim të Ministrit.

29.2. Masat që merren nga drejtuesi i mjetit, në rastet kur karta e tahografit dixhital humbet, vidhet, ose keqfunksionon, si dhe keqpërdorimi i saj parashikohen me udhëzim të Ministrit.

29.3. Organet e transportit sipas pikës 11 dhe 12, të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Policia Rrugore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Inspektorati Shtetëror i Punës, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, Policia Tatimore në bashkëpunim me njëra tjetrën ose veç marrin masa në ushtrimin e kontrolleve periodike, në anë të rrugës dhe, ose në zyrat e ndërmarrjes, për zbatimin e kësaj rregulloreje.

### 30. Sanksionet

30.1. Në rastin kur, një sipërmarrje e transportit rrugor ose drejtuesi i mjeti, gjatë operacionit, kryen shkelje serioze ose shkelje të vogla të përsëritura të kësaj rregulloreje, brenda vendit, ose për në, në, përmes ose nga territori i një shteti tjetër, ndaj tij regjistrohen në regjistrin elektronik sipas pikës 32.

Shkeljet e sipërmarrjes të transportit rrugor ose drejtuesit të mjeti dënohen sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" dhe ligjin 9634, datë 12.07.1995 "Për inspektimin në punë dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës".

30.2. Në rastin kur një operator i transportit rrugor i vendosur në një shtet tjetër ose drejtuesi i mjetit të saj, gjatë operacionit, kryen shkelje serioze ose shkelje të vogla të përsëritura të dispozitave të kësaj rregulloreje, ndaj tij vendosen sanksione që parashikon ligji nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", si dhe institucionet e parashikuara në pikën 33 i komunikojnë autoriteteve përgjegjëse të shtetit, të vendosjes së tij, të gjithë informacionin që zotërojnë për shkeljen, si dhe masat ndëshkimore që janë marrë ndaj tij.

30.3. Prodhimi, pajimi ose instalimi i prodhimeve të cilat interferojnë me funksionimin e tahografit ose regjistrimeve të treguara nga një tahograf përbën një shkelje të drejtave të prodhuesve të autorizuar për pajisje të tilla, dhe çon në sanksione në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### 31. Përgjashtimi nga sanksionet

31.1. Në rastin e shkeljeve e rregullave të orëve, të këtij akti, nuk vendosen sanksione për:

- a) drejtuesin e mjetit, i cili për arsye të vështirësive të paparashikuara ka qenë në përfundimin e udhëtimit dhe shkel rregullat e këtij akti; dhe

b) punëdhënësin, nëse ndonjë drejtues mjeti është i përfshirë në një punë tjetër si drejtues mjeti, dhe, i cili nuk e ka vënë në dijeni punëdhënësin për këtë.

31.2. Në rastin e shkeljeve të regjistruara, nuk vendosen sanksione ndaj punëdhënësit nëse provon se ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që drejtuesi i mjetit mban regjistrimet e duhura me vete.

### **32. Regjistrimi i shkeljeve**

Në zbatim të kësaj rregulloreje çdo shkelje e dispozitave të saj regjistrohet në Regjistrin Elektronik Kombëtar, në përputhje me VKM nr.325, datë 19.04.2008 “Rregullat për Pranimin në Veprimtarinë e Operatorit të Transportit Rrugor të Udhëtarëve dhe Mallrave, si dhe Njohja e Dokumenteve Zyrtarë të Caktuar për këta Operatorë”.

### **33. Shkëmbimi i informacionit**

Drejtoritë, të cilat mbulojnë Transportin dhe Qarkullimin Rrugor, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor pranë MPPTT, janë pika kontakti për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm me shtetet e tjera në lidhje me ndërmarrjet e transportit rrugor të vendosura në Shqipëri në zbatim të kësaj rregulloreje.

### **34. Hyrja në fuqi**

34.1. Mjetet e regjistruar për herë të parë pas datës 1 Maj 2006 duhet të jenë të pajisur me tahograf dixhital. Mjetet e futur në shërbim para kësaj date mund të përdorin ose tahograf analog ose tahograf digital.

34.2. Pikat e kësaj rregulloreje, të cilat lidhen me tahografin dixhital do të hynë në fuqi pesë vjet pas hyrjes në fuqi të rregullores. Njëzetë e katër muaj para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, drejtuesit e mjeteve, që përfshihen në këtë rregullore, duhet të pajisen me kartën e tahografit dixhital.

34.3 Përjashtimisht pikës 34.1, me qëllim plotësimin e dispozitave të rregullores, mjetet e regjistruar për herë të parë pas datës 1 maj 2006 duhet të jenë të pajisur me të dy llojet e tahografëve, deri në plotësimin e pikës 34.2.

## Aneksi 1

Për qëllime të këtij ligji do të zbatohen përkufizimet që vijojnë:

a) “mjet” nënkupton një mjet motorik, tërheqës, rimorkio ose gjysmë – rimorkio ose një kombinim i këtyre mjeteve, i përcaktuar si vijon:

1) “mjet motorik”: çdo mjet vetëlëvizës që udhëton mbi rrugë, përveç një mjeti që udhëton në mënyrë permanente mbi shina, dhe normalisht i përdorur për mbartjen e udhëtarëve dhe mallrave,

2) “tërheqës”: çdo mjet vetëlëvizës që udhëton mbi rrugë, përveç një mjeti që udhëton në mënyrë permanente mbi shina, dhe i përcaktuar për të tërhequr, shtyrë ose lëvizur rimorkiot, gjysmë – rimorkiot, pajisje ose makineri,

3) “rimorkio”: çdo mjet për t’u çiftuar me një mjet motorik ose tërheqës,

4) “gjysmë – rimorkio”: një rimorkio pa një aks ballor të çiftuar në një mënyrë të tillë që pjesa e rëndësishme e peshës së saj dhe e peshës së ngarkesës së saj përballohet.

b) “AETR” nënkupton Marrëveshjen Europiane në lidhje me punën e ekuipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor;

c) “transporti me rrugë” nënkupton çdo udhëtim të kryer plotësisht ose pjesërisht mbi rrugët publike me anën e një mjeti, qoftë i ngarkuar ose jo, i përdorur për transportin e mallrave ose udhëtarëve.

ç) “drejtues mjeti” nënkupton çdo person, i cili drejton mjetin qoftë edhe për një periudhë të shkurtër, ose, i cili, mbartet në mjet si pjesë e detyrimeve të tij për të qenë i gatshëm për drejtimin e mjetit nëse kërkohet;

d) “periudhë ndërprerje/(pauzë)” nënkupton çdo periudhë gjatë të cilës drejtuesi i mjetit nuk mund të kryej drejtimin e mjetit ose ndonjë punë tjetër dhe, e cila përdoret ekskluzivisht për rikuperim;

dh) “punë tjetër” nënkupton të gjithë veprimtaritë, të cilat përcaktohen si kohë pune në përputhje me pikën 4.1, me përjashtim të kohës së “drejtimin e mjetit”, për të njëjtin ose tjetër punëdhënës;

e) “pushim” nënkupton çfarëdo periudhe të pandërprerë jo më pak se një orë, gjatë të cilës një drejtues mjeti mund të vendosë lirisht për kohën e tij;

f) “periudhë e pushimit ditor” nënkupton çfarëdo periudhe ditore gjatë të cilës drejtuesi i mjetit vendos lirisht për kohën e tij dhe mbulon një “periudhë e pushimit ditor të rregullt” dhe një “periudhë të pushimit ditor të reduktuar”:

– “periudhë e pushimit ditor, të rregullt” nënkupton çdo periudhë të pushimit çlodhës ditor prej e pakën 11 orë. Në mënyrë alternative, kjo periudhë e rregullt, e pushimit ditore mund të përdoret (merret) në dy

periudha, e para prej të cilave duhet të jetë një periudhë e pandërprerë prej të pakën 3 orë dhe e dyta një periudhë e pandërprerë prej të pakën 9 orë,

- “periudhë e pushimit ditor të reduktuar,” nënkupton çdo periudhë të pushimit prej 9 orë të pakën, por më pak se 11 orë;

g) “periudhë e pushimit javor” nënkupton periudhën javore gjatë të cilës një drejtues mjetit mund të vendosë lirisht për kohën e tij dhe mbulon një “periudhë e pushimit javor, të rregullt” dhe një “periudhë e pushimit javor të reduktuar”:

- “periudhë e pushimit javor të rregullt” nënkupton çdo periudhë të pushimit të çlodhës prej 45 orë të pakën,
- “periudhë e pushimit javor të reduktuar” nënkupton çdo periudhë të pushimit çlodhës prej më pak se 45 orë, e cila varet nga kushtet e përcaktuar në pikën 9 mund të shkurtohet deri në një minimum prej 24 orë rresht;

h) “një javë” nënkupton periudhën e kohës ndërmjet 00.00 të ditës së hënë dhe 24.00 të ditës së dielës;

i) “koha e drejtimit të mjetit” nënkupton kohëzgjatjen e veprimtarisë së drejtimit të mjetit e regjistruar:

- në mënyrë automatike ose gjysmë-automatike në varësi të pajisjes së regjistrimit (tahografit), ose
- në mënyrë manuale siç kërkohet në kapitullin IV;

j) “kohëzgjatja ditore e drejtimit të mjetit” nënkupton kohën e përgjithshme të drejtimit të mjetit të mbledhur ndërmjet fundit të një periudhe të pushimit ditore dhe fillimit të periudhës së pushimit, ditore që vijon ose ndërmjet një periudhe të pushimit ditore dhe një periudhe pushimi javore.

k) “kohëzgjatja javore e drejtimit të mjetit” nënkupton kohën e përgjithshme të drejtimit të mjetit të mbledhur gjatë një jave;

l) “punëtor i lëvizshëm” nënkupton çdo punëtor pjesë e formacionit të stafit udhëtues, që përfshin stazhierët e kursantët, i cili është në shërbim të një ndërmarrje që kryen shërbime transporti për udhëtarë ose mallra me rrugë për të tretë ose me qira, ose për llogari të vet;

ll) “ekuipazh i shumëfishtë” nënkupton gjendjen ku, gjatë secilës periudha e drejtimit të mjetit ndërmjet çdo dy periudhave të pushimit ditor, të njëpasnjëshme, ose ndërmjet një periudhe të pushimit ditor dhe një periudhe të pushimit javor, ndodhen të pakën dy drejtues për drejtimin e mjetit. Për orën e parë të ekuipazhit, prezenca e drejtuesit ose e drejtuesve të tjerë është opsionale por për periudhën e mbetur ajo është e detyrueshme;

m) “ndërmarrje transporti” nënkupton çdo person fizik ose juridik për qëllime fitimi



apo jo, çdo shoqatë ose grup individësh, pa personalitet juridik, me qëllim fitimi ose jo, apo çdo organ zyrtar, që ka personalitetin e vet ligjor ose që varet nga një organ që e ka këtë personalitet;

n) “periudhë e drejtimit të mjetit” nënkupton kohën e drejtimit të mjetit totale të mbledhur, që kur drejtuesi i mjetit fillon drejtimin e mjetit që pason periudhën e pushimit ose një ndërprerje deri sa ai të marrë periudhën e pushimit ose një ndërprerje. Periudha e drejtimit të mjetit mund të jetë e vazhdueshme ose e ndërprerë;

o) “kohë nate” nënkupton periudhën prej jo më pak se katër orë, ndërmjet orës 22<sup>00</sup> deri në orën 6<sup>00</sup>;

p) “punë nate” nënkupton punën që kryhet gjatë kohës së natës (nga ora 22<sup>00</sup> deri në orën 6<sup>00</sup> të mëngjesit të ditës pasuese.

q) “mallra” nënkupton mallrat ose ngarkesa të çdo lloji sipas përshkrimit;

r) “punëtor i lëvizshëm” nënkupton çdo punëtor pjesë e formacionit të stafit udhëtues, duke përfshirë stazhin dhe mësimin e profesionit, i cili është në shërbimin e sipërmarrjes e cila operon në shërbimet e transportit rrugor për udhëtarë ose mallra me qira ose shpërbim ose për llogari të vetë;

rr) “personi që kryen veprimtari transporti rrugor të lëvizshëm” nënkupton çdo punëtor të lëvizshëm ose drejtues mjeti i vetë-punësuar i cili kryen të tilla veprimtari;

s) “koha e punës” nënkupton të gjithë veprimtaritë, të cilat përcaktohen si kohë pune në përputhje me pikën 4, me përjashtim të periudhës së gatishmërisë;

t) “periudha e gatishmërisë” nënkupton të gjithë veprimtaritë, të cilat përcaktohen në përputhje me pikën 5;

th) “pajisje regjistrimi (tahografi)” nënkupton pajisjen e destinuar për instalimin në mjetet rrugore për të treguar dhe regjistruar në mënyrë automatike ose gjysmë-automatike detaje (hollësi) të lëvizjes së këtyre mjeteve dhe disa periudha të punës së drejtuesve të tyre;

u) “transferim elektronik” nënkupton kopjimin e një pjese ose një komplet të të dhënave të magazinuara në memorien e njësisë së mjetit ose në një kartë elektronike tahografi;

v) “shërbim i rregullt i udhëtarëve” nënkupton transportin e udhëtarëve në itinerare dhe vendqëndrime të pandryshuara, të ofruara nga transportuesi dhe të përcaktuara më parë në rregulloren e udhëtimit. Ky shërbim kryhet vetëm me autobusë dhe mund të jetë qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës dhe ndërkombëtar.

x) “masa e lejuar, maksimale” nënkupton masën operuese të autorizuar, maksimale të një mjeti kur ai është i ngarkuar plotësisht;

## Aneksi 2

1. Tabelat e mëposhtme tregojnë rregullat që zbatohen te disa lloje mjetesh të transportit të udhëtarëve.

### Lloji i drejtimit

### Nr. i përgjithshëm i vendeve duke përfshirë edhe drejtuesin e mjetit

#### Mjetet private, jo të shërbimit publik dhe të lejuara

	Me 9 <sup>‡</sup> vende ulje	Me 10 deri në 13 <sup>#</sup> vende ulje	Me 14 – 17 <sup>#</sup> vende ulje	Me dhe mbi 18 vende ulje
Policia, zjarrfikësit dhe forcat e armatosura	Nuk përfshihet nga rregullat	Nuk përfshihet nga rregullat	Nuk përfshihet nga rregullat	Nuk përfshihet nga rregullat
Shërbimet publike ose komunale	Nuk përfshihet nga rregullat	Rregullat e veçanta sipas pikave 16 dhe 18 <sup>▲</sup>	Rregullat e veçanta sipas pikave 16 dhe 18	Rregullat sipas pikave 6 – 9
Udhëtime brenda vendit, private ose për llogari të vet	Nuk përfshihet nga rregullat	Rregullat e veçanta sipas pikave 16 dhe 18	Rregullat e veçanta sipas pikave 16 dhe 18	Rregullat sipas pikave 6 - 9
Udhëtime ndërkombëtare (përfshirë përdorim privat)	Nuk përfshihet nga rregullat	Rregullat e AETR-së	Rregullat e AETR-së	Rregullat e AETR-së

#### Shërbimet e rregullta, shërbimet e rregullta të specializuara (të brendshme dhe, ose ndërkombëtare) me mjete të shërbimit publik

Udhëtime që nuk i kapërcen 50 km	Rregullat e veçanta sipas pikës 16 <sup>•</sup>	Rregullat e veçanta sipas pikës 16	Rregullat e veçanta sipas pikës 16	Rregullat e veçanta sipas pikës 16
Udhëtime të brendshme që i kapërcejnë 50 km	Rregullat e veçanta sipas pikës 15 <sup>•</sup>	Rregullat e veçanta sipas pikës 15	Rregullat e veçanta sipas pikës 15	Rregullat sipas pikave 6 - 9*
Operacione ndërkombëtare që i kapërcejnë 50 km.	Rregullat e veçanta sipas pikës 15 <sup>†</sup>	Rregullat e AETR-së	Rregullat e AETR-së	Rregullat e AETR-së

#### Shërbimet e rastit, vajtje-ardhje dhe taksi me mjete të shërbimit publik

Udhëtime të brendshme (d.m.th. shërbimet vajtje – ardhje ose të rastit)	Nuk ka	Rregullat e veçanta sipas pikës 16	Rregullat e veçanta sipas pikës 16	Rregullat sipas pikave 6 – 9
Udhëtime ndërkombëtare (d.m.th. shërbimet vajtje – ardhje ose të rastit)	Rregullat sipas pikave 6 – 9 <sup>‡</sup>	Rregullat e AETR-së	Rregullat e AETR-së	Rregullat e AETR-së
Shërbimi taksi me autovetura 8+1 vende	Rregullat e brendshme sipas pikave 6 – 9 <sup>‡</sup>	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka

Me 9 vende ulje      Me 10 deri në 13<sup>#</sup> vende ulje      Me 14 – 17<sup>#</sup> vende ulje      Me dhe mbi 18 vende ulje

# Nëse mjete me këtë përmasë përdoret në segmentin e brendshëm të një udhëtimi ndërkombëtar por nuk e lë Shqipërinë, rregullat e brendshme zbatohen për këtë pjesë të udhëtimit.

▲ Mjetet me qëllim shërbimet “publike” ose “komunale” deri në 13 vende (përfshirë edhe atë të drejtuesit të mjetit) duhet të përputhen me rregullat e veçanta kur operohen sipas një leje të drejtuesit të mjetit të punësuar.

- \* Përfshirja nga dispozitat e të pikave 6 – 9 të rregullores ku tahografi, megjithëse i rekomanduar fort, nuk përdoret, nëse një ekstrakt nga regjistri i shërbimit dhe një kopje e listës së shërbimeve mbartet nga drejtuesi i mjetit.
- † Në transportin ndërkombëtar, rregullat e AETR-së nuk zbatohen, por zbatohen rregullat e vendit ku udhëtohet.
- ‡ Rregullat e pikave 6 – 9 zbatohen për autoveturat me 8+1 vende të licencuara në shërbimin taksit.
- Përfshirja nga dispozitat e të pikave 6 – 9 të rregullores ku tahografi, megjithëse i rekomanduar fort, nuk përdoret, nëse drejtuesi i mjetit mban me vete një ekstrakt nga regjistri i shërbimit dhe një kopje të listës së shërbimeve të rregullta në linja rrethqytetëse me autovetura me 8+1 vende

Tabela 1 e përputshmërisë

<p>1. Rregullorja (EC) No 561/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit e 15 Marsit 2006 “Mbi harmonizimin e disa ligjeve në lidhje me Transportin Rrugor që amendon Rregulloren e Këshillit (EEC) No 3821/85 dhe (EC) No 2135/98 dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (EEC) No 3820/85”, botuar në Fletoren Zyrtare L 102, datë 11.04.2006, faqe 1-14 dhe Direktiva 2002/15/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 11 Marsit 2002 “Në Organizimin e Kohës së Punës të Personave që Kryejnë Veprimtari Transporti të Lëvizshëm”, botuar në Fletoren Zyrtare L 80, datë 23.03.2002, faqe 35-39.</p> <p>Rregullorja 561/2006 dhe Direktiva 2002/15 kanë për qëllim harmonizimin e kushteve të konkurrencës në veprimtarinë e transportit rrugor, si dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe sigurisë rrugore, si dhe organizimin e kushteve të punës të këtyre personave. Në rregullore dhe direktivë lejojnë që marrëveshjet ndërmjet të dy anëve të industrisë së transportit për të vendosur dispozita më favorizuese për punonjësit. Rregullorja 561/2006 është pothuajse në një linjë me Marrëveshjen Europiane në lidhje me Punën e Ekuipazheve të Përfshira në Transportin Ndërkombëtar Rrugor e 1 Korrikut 1970 (AETR), të ndryshuar. Brenda 2 vjetëve të hyrjes në fuqi të rregullores Marrëveshja e mësipërme do të jetë plotësisht në një linjë me këtë rregullore.</p>				
<p>2. Projektvendimi mbi “Rregullat në Organizimin e Kohës së Punës të Personave, që Kryejnë Transport Rrugor, Për Orët e Drejtuesve të Mjeteve dhe Pajisjet e Regjistrimit” është akt ligjor i plotë në organizimin e kushteve sociale të punës për punëtorët e lëvizshëm, i cili buron nga Ligji nr 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” dhe Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”. Projektvendimi, sipas MSA-së, është në përputhje me Rregulloren (EC) No 561/2006 dhe Direktivën 2002/15/EC.</p>				
<p>3. Ndryshimet që janë parashikuar të kryhen në Projektvendim e përafrojnë atë pjesërisht me Rregulloren 516/2006 dhe Direktivën 2002/15.</p> <p style="text-align: center;">Shkalla e përafritimit e pjesshme.</p>				
Rregullorja 561/2006 dhe Direktiva 2002/15				
a)	b)	c)	d)	e)
Nenet dhe pjesë të legjislacionit të Rregullores 561/2006 dhe Direktivës 2002/15.	parashikimet e projektaktit	përputhja e projektaktit me legjislacionin e BE-së (i plotë; i pjesshëm; Jo i aplikueshëm)	arsyet për përputhje të pjesshme	periudha e parashikuar për përputhje të plotë
Neni 1, i Rregullores 561/2006 dhe Neni 1, i Direktivës 2002/15.	Kapitulli I, pika 1.	E plotë.		
Neni 2, i Rregullores 561/2006 dhe Neni 2, i Direktivës 2002/15..	Kapitulli I, pika 2.	E pjesshme		
Neni 3, i Rregullores 561/2006	Kapitulli I, pika 3.1	E plotë		
Neni 4, i Rregullores 561/2006 dhe neni 3, i	Aneksi 1	E plotë		

Direktivës 2002/15.				
Neni 4, i Direktivës 2002/15.	Kapitulli II, pika 4	E plotë		
Neni 5, i Rregullores 561/2006 dhe neni 3, i Direktivës 2002/15.	_____	Nuk është parashikuar		
Neni 6, i Rregullores 561/2006	Kapitulli II, pika 6	E plotë.		
Pika 5, e nenit 6, të Rregullores 561/200	Kapitulli II, pika (v), e shkronjës “a”, të pikës 4 dhe pika 5	E plotë.		
Neni 7, i Rregullores 561/2006 dhe neni 5, i Direktivës 2002/15.	Kapitulli II, pika 7.	E plotë.		
Neni 8, i Rregullores 561/2006 dhe neni 6, i Direktivës 2002/15.	Kapitulli II, pika 8 dhe 9	E plotë		
Neni 9, i Rregullores 561/2006	Kapitulli II, pika 10	E plotë		
Neni 7, i Direktivës 2002/15	Kapitulli II, pika 11.	E plotë.		
Neni 8, i Direktivës 2002/15	Kapitulli I, pika 4.2 dhe 4.3.			
Neni 9, i Direktivës 2002/15	Kapitulli II, pika 12	E plotë.		
Neni 10, i Rregullores 561/2006”	Kapitulli III, pika 13.	E pjeshme.		
Neni 11, i Rregullores 561/2006	Kapitulli IV, pika 17.4 – 16.6, 18	E pjeshme		
Neni 12, i Rregullores 561/2006	Kapitulli III, pika 14	E plotë		
Neni 13, i Rregullores 561/2006	Kapitulli I, pika 3.2	E plotë.		

Neni 14, i Rregullores 561/2006	Kapitulli III, pika 15	E plotë.		
Neni 15, i Rregullores 561/2006	Kapitulli IV, pika 17	E plotë.		
Neni 16, i Rregullores 561/2006	Kapitulli III, pika 16	E pjeshme		
Neni 18, të Rregullores 561/2006	Kapitulli VII, pika 29, 34.1, 34.2	E pjeshme		
Neni 19, të Rregullores 561/2006	Kapitulli VII, pika 30, 31 dhe pika 6 e 7, e nenit 176 dhe pika 4 e nenit 177, të ligjit 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”	E plotë		
Neni 20, i Rregullores 561/2006	Kapitulli VII, pika 32	E plotë.		
Neni 21, i Rregullores 561/2006	Kapitulli VII, pika 30, ligji 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, pika 32.	E pjeshme		
Neni 22, i Rregullores 561/2006	Kapitulli VII, pika 33.	E pjeshme		
Neni 23, i Rregullores 561/2006				
Neni 24, i Rregullores 561/2006				
Neni 25, i Rregullores 561/2006				
Neni 26, i Rregullores 561/2006				
Neni 27, i Rregullores 561/2006				
Neni 28, i Rregullores 561/2006				
Neni 29, i Rregullores 561/2006				

Tabela 2 e përputhshmërisë

<p>1. Projektvendimi mbi “Rregullat në Organizimin e Kohës së Punës të Personave, që Kryejnë Transport Rrugor, Për Orët e Drejtuesve të Mjeteve dhe Pajisjet e Regjistrimit” është akt ligjor i plotë në organizimin e kushteve sociale të punës për punëtorët e lëvizshëm, i cili buron nga Ligji nr 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” dhe Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”. Projektvendimi, sipas MSA-së, është në përputhje me Rregulloren (EC) No 561/2006 dhe Direktivën 2002/15/EC.</p>				
<p>2. Rregullorja (EC) No 561/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit e 15 Marsit 2006 “Mbi harmonizimin e disa ligjeve në lidhje me Transportin Rrugor që amendon Rregulloren e Këshillit (EEC) No 3821/85 dhe (EC) No 2135/98 dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (EEC) No 3820/85”, botuar në Fletoren Zyrtare L 102, datë 11.04.2006, faqe 1-14 dhe Direktiva 2002/15/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 11 Marsit 2002 “Në Organizimin e Kohës së Punës të Personave që Kryejnë Veprimtari Transporti të Lëvizshëm”, botuar në Fletoren Zyrtare L 80, datë 23.03.2002, faqe 35-39.</p> <p>Rregullorja 561/2006 dhe Direktiva 2002/15 kanë për qëllim harmonizimin e kushteve të konkurrencës në veprimtarinë e transportit rrugor, si dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe sigurisë rrugore, si dhe organizimin e kushteve të punës të këtyre personave. Në rregullore dhe direktivë lejojnë që marrëveshjet ndërmjet të dy anëve të industrisë së transportit për të vendosur dispozita më favorizuese për punonjësit. Rregullorja 561/2006 është pothuajse në një linjë me Marrëveshjen Europiane në lidhje me Punën e Ekuipazheve të Përfshira në Transportin Ndërkombëtar Rrugor e 1 Korrikut 1970 (AETR), të ndryshuar. Brenda 2 vjetëve të hyrjes në fuqi të rregullores Marrëveshja e mësipërme do të jetë plotësisht në një linjë me këtë rregullore.</p>				
<p>3. Ndryshimet që janë parashikuar të kryhen në Projektvendim e për afrojnë atë pjesërisht me Rregulloren 516/2006 dhe Direktivën 2002/15.</p> <p style="text-align: center;">Shkalla e përafritit e pjesshme.</p>				
<p>Projektvendimi mbi “Rregullat në Organizimin e Kohës së Punës të Personave, që Kryejnë Transport Rrugor, Për Orët e Drejtuesve të Mjeteve dhe Pajisjet e Regjistrimit”</p>				
a)	b)	c)	d)	e)
Parashikimet e projektaktit	Pjesë të legjislacionit të Rregullores 561/2006 dhe Direktivës 2002/15/KE-së që për afrohen	përputhja e projektaktit me legjislacionin e BE-së (i plotë; i pjesshëm; Jo i aplikueshëm)		
Kapitulli I, pika 1.	Neni 1, Rregullores 561/2006 dhe neni 1, i Direktivës 2002/15.	E plotë.		
Kapitulli I, pika 2	Neni 2, i Rregullores 561/2006 dhe neni 2, i Direktivës 2002/15.	E pjesshme.		
Kapitulli I, pika 3.1	Neni 3, i Rregullores 561/2006	E plotë.		
Kapitulli I, pika 3.2	Neni 13, i Rregullores 561/2006	E plotë.		
Kapitulli II, pika 4	Neni 4, i Direktivës 2002/15	E plotë.		
Kapitulli II, pika (v), e shkronjës “a”, të pikës 4.1	Pika (v), e shkronjës “a”, të Nenit 3 Direktivës 2002/15.	E plotë.		

Kapitulli II, pika 4.2 dhe 4.3	Neni 8, i Direktivës 2002/15	E plotë.		
Kapitulli II, pika 5	Shkronja “b”, e Nenit 3 të Direktivës 2002/15	E plotë		
Kapitulli II, pika 6	Neni 6, i Rregullores 561/2006	E plotë.		
Kapitulli II, pika 7	Neni 7, i Rregullores 561/2006 dhe neni 5, i Direktivës 2002/15	E plotë		
Kapitulli II, pika 8 dhe 9	Neni 8, i Rregullores 561/2006 dhe neni 6, i Direktivës 2002/15	E plotë		
Kapitulli II, pika 10	Neni 9, i Rregullores 561/2006	E plotë.		
Kapitulli II, pika 11.	Neni 7, i Direktivës 2002/15	E plotë.		
Kapitulli II, pika 12	Neni 9, i Direktivës 2002/15	E plotë.		
Kapitulli III, pika 13	Neni 10, i Rregullores 561/2006	E pjesëshme.		
Kapitulli III, pika 14	Neni 12, i Rregullores 561/2006	E plotë.		
Kapitulli III, pika 15	Neni 14, i Rregullores 561/2006	E plotë.		
Kapitulli IV, pika 16	Neni 16, i Rregullores 561/2006	E plotë.		
Kapitulli IV, pika 16.6 – 17.4, 18 17	Neni 11, i Rregullores 561/2006	E pjesëshme		
Kapitulli IV, pika 19				
Kapitulli IV, pika 20				
Kapitulli IV, pika 21				
Kapitulli IV, pika 22				
Kapitulli V, pika 23				
Kapitulli V, pika 24				
Kapitulli V, pika 25				
Kapitulli V, pika 26				
Kapitulli V, pika 27				
Kapitulli VII, pika 29	Neni 18 dhe 19, të Rregullores	E plotë		



	561/2006			
Kapitulli VII, pika 30 dhe pika 6 e 7, e nenit 176 dhe pika 4 e nenit 177, të ligjit 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”	Neni 18 dhe 19, të Rregullores 561/2006	E plotë		
Kapitulli VII, pika 31	Neni 19, të Rregullores 561/2006	E plotë		
Kapitulli VII, pika 32	Neni 20, të Rregullores 561/2006			
Kapitulli VII, pika 33	Neni 22, i Rregullores 561/2006			
Kapitulli VII, pika 33.1, 33.2	Neni 18, i Rregullores 561/2006			